



V E N D I M

K.P.P. 490/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.07.2018 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt, “Blerje Shtypshkrimesh”, me nr. REF-66306-04-30-2018, me fond limit 44,607,547 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Cerciz Topulli”, nr.17, Kashar, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Posta Shqiptare sh.a.
Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, nr. 4, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.05.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Blerje Shtypshkrimesh*”, me nr. REF-66306-04-30-2018, me fond limit 44,607,547 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

II.2. Në datën 07.02.2018, operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues nëpërmjet shkresës nr. 1662/1 prot., datë 09.05.2018, duke e pranuar pjesërisht atë.

II.4.Në datën 18.05.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon: “[...]/Ne datën 14-05-2018, U njohem me pergjigjen e autoritetit kontraktor me shkresën nr. 1662/1 prot., datë 09.05.2018 nepermjet të ciles njihemi se janë pranuar disa pra pretendimeve tona, pra ankesa jone është pranuar pjesërisht. Me poshtë i drejtohem Komisionit të Prokurimit Publik si organi më i lartë në fushën e prokurimeve publike dhe bazuar edhe në nenin 63 të ligjit për prokurimin publik duke kundërshtuar kriteret si më poshtë: Pretendimi jone për heqjen e Certifikates ISO 27001: 2013 është pranuar nga autoriteti kontraktor. Pretendimi jone për makineritë është pranuar pjesërisht: në dokumentat e tenderit janë kërkuar disa makineri si më poshtë: makineri shtypi në rrulën; si dhe makineri për mbledhjen e letres me birosje; makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabël; si dhe makineri për numrator dhe barkod dixhital. Nga autoriteti kontraktor në kthimin e pergjigjes nuk është dhënë asnjë argument dhe fakt se pse janë të domosdoshme këto makineri kur në fakt në specifikimet teknike nuk është percaktuar ndonjë funksion pune për këto makineri. Në Vendimin nr. 914, të Këshillit të Ministrave, në nenin 27 nuk është percaktuar asnjë kriter për makineri apo pajisje, sepse këto dokumenta janë dokumenta mallra dhe procedura e prokurimit është blerje malli prandaj nuk percaktohet asnjë makineri për këto kontrate. Megjithatë, në kundërshtojmë gjithashtu këto kriter për makineritë sepse autoriteti kontraktor i ka vendosur ato duke mos qenë në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe objektin e prokurimit. Autoriteti kontraktor pajisjet duhet t'i vendosë në përputhje me objektin e kontratës dhe në këto rast nuk mund të kërkojë makineri për cdo lloj malli, kur në këto rast nuk e kemi shërbim por mall sepse është blerje dhe jo prodhim dhe nuk mund të kërkojë pajisje për një subjekt që e blen mallin dhe ja siguron autoritetit kontraktor kontratën sipas të gjitha kërkesave. Makineritë e mesipërme janë në tejkalim të kërkesave dhe diskriminuese sepse nuk përputhen me shtypshkrimet e kërkuara. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë makineri të tilla kur në fakt mund të jetë vetëm një produkt ose asnjë i cili kërkon këto lloj makinerie. Me konkretisht në rastin e makinerisë për mbledhjen e letres me birosje, autoriteti kontraktor nuk duhet të kufizohet vetëm në këto lloj makinerie duke kërkuar një makineri me të dyja funksionet, procesi në makineri mund të jetë në dy komponente të ndryshme të saj (mbledhje dhe birosje), ose mund të jenë në dy makineri të vecanta. AK ka kërkuar një makineri tek e cila ka përmblëdhur dy funksione edhe atë të mbledhjes së letres dhe atë të birosjes, kur në fakt procesi i mbledhjes së letres bëhet i vecantë dhe nuk ka lidhje nëse letra është apo jo e birosur. Pra një makineri mbledhëse mund të kryejë mbledhjen e letres në çfaredolloj opsioni me apo jo të birosur. Këtu përmendim që nga ana e AK mund të kërkojnë të paraqiten dy makineri të ndryshme secila me nga një funksion pra një për mbledhjen e letres dhe një për birosjen e saj, e rendesishme për autoritetin është të realizohet kontrata por jo me kritere diskriminuese duke vendosur kushte përjashtuese vetëm për një makineri, për më tepër kur procesi i kësaj makinerie (ai i mbledhjes) nuk është i lidhur ngushtë me faktin nëse letra është apo jo e birosur, pasi makineritë e mbledhjes së letres e mbledhin letren në cdo lloj versioni dhe formati. Sa më sipër kërkojmë që kriteri për makineri të percaktohet saktë dhe qartë duke u ndarë dhe duke u percaktuar që makineria për mbledhjen e letres është e ndryshme nga ajo e birosjes pra për të plotësuar kërkesat e autoritetit kontraktor të percaktohet që të paraqiten dy makineri të ndarë vec e vec të cilat kryejnë funksionet e kërkuara nga autoriteti. Pra një makineri për mbledhjen e

letres dhe nje makineri per birosjen e letres dhe nuk ka pse te kerkohet vetem nje makineri qe kryen te dyja funksionet, duke lene hapesine per nje pjesemarrje me te gjere dhe duke mos penguar dhe perjashtuar operatoret ekonomike te interesuar, pasi ne kete gjykim te autoritetit kontraktor i bie te kerkonte nje makineri per te gjitha funksionet, kriter ky diskriminues. Autoriteti kontraktor duhet te percaktoje kriteret minimale dhe te tilla qe te lejoje nje pjesemarrje te gjere.

Ne lidhje me sample dhe mostrat e kerkuara autoriteti kontraktor edhe ne kthimin e pergjigjes nuk ka dhene asnje fakt e argument konkret por thjesht ka cituar rregullat e prokurimit publik dhe duke mos arsyetuar vendosjen e ketij kriteri nderkohe qe ne kemi argumentuar se pse duhet modifikuar ky kriter. Per mostrat sqarojme se: Ne Vendimin 914 date 29.12.2014 te Keshillit te ministrave percaktohet se: *Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; Verejme se ne dokumentat e tenderit jane kerkuar mostrat te cilat kane nje kosto per operatorin ekonomik dhe ne kushtet kur autoriteti kontraktor ka kerkuar nje sere deshmish per te vertetuar se operatori ekonomik ploteson kerkesat minimale, mendojme se nuk eshte e domosdoshme te kerkohen edhe mostra per cdo produkt. Qellimi i autoritetit kontraktor arrihet me se miri edhe nese autoriteti kontraktor kerkon mostra nga nje te tille per cdo grup artikuj duke mos krijuar edhe kosto per operatorin ekonomik si edhe duke mos krijuar konfuzion edhe ne depozitim e tyre prane autoritetit kontraktor. Kerkojme saktesimin dhe ndryshimin e kriterit per mostra duke u kerkuar si te tilla nga nje moster per cdo grup produkti, per kete e mbeshtesim pretendimin ne vendimin qe KPP ka mbajtuar ne vitin 2017 me Nr.433/2017. Autoriteti kontraktor duhet te argumentojte cdo kriter dhe specifikim te hartuar e te kerkuar ne dokumentat e tenderit, duke dhene faktet dhe bazen ligjore per percaktimin e tyre, nderkohe qe autoriteti ka cituar vetem ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Duam te veme ne dukje edhe njehere per kriterin ne lidhje me mostrat, qe autoriteti mos vendose kritere penguese dhe diskriminuese por te lehtesojte kriteret qe percakton duke lehtesuar edhe pjesemarrjen e opereve ekonomike ne procedure, se ky eshte dhe qellimi i ligjit dhe rregullave te prokurimit qe kane ndryshuar se fundmi. Specifikimet teknike dhe grafika perkatese ne lidhje me mostrat qe do dorezohen duhet te jene te qarta dhe te plota pasi ne DST jane vendosur vetem skanime (jo file dhe grafika perfundimtare per prodhimin e ketyre produkteve) te ketyre produkteve numrat e te cilave nuk korespondonje me ato te kerkeses per realizim te samples sipas sasise dhe grafikut te levrimit Mostra nuk eshte një produkt perfundimtar por eshte nje sample per ti vertetuar autoritetit kontraktor qe nje operator eshte ne gjendje te prodhoje një produkt te tille, nderkohe qe eksperienca e tij vertetohet edhe e dokumenta te tjera si kontrata te ngjashme, certifikata iso etj, qe vertetojne se operatori ekonomik prodhon produkte te ndryshme shtypshkrime persa kohe qe ka kete dokumentacion si edhe objektin e veprimtarise ne fushen e shtypshkrimeve. Edhe vete*

rregullat e prokurimit publik neni 27 i VKM 914 qe eshte cituar nga autoriteti kontraktor ne kthim pergjigje, percakton se Autoriteti kontraktor mund t'u kerkoje operateve ekonomike te dorezojne deshmi si mostra malli etj, pra ky kriter persa kohe qe eshte me fjalen "mund" do te thote qe nuk eshte domosdoshmerisht i nevojshem dhe jo kusht detyrues, prandaj nuk eshte qellim ne vetvete i autoritetit kontraktor per te penguar apo penalizuar operatorin ekonomik. Per kete qellim kerkojme qe te modifikohet kriteri per mostrat duke i kerkuar ato per grup produktesh persa kohe qe objekti i prokurimit ka shume artikuj dhe qellimi i autoritetit kontraktor per te verifikuar nese operatori ekonomik eshte ne gjendje te sjelle produkte te tilla arrihet edhe me nje percaktim te tille. [...]"

II.5.Në datën 29.05.2018, nëpërmjet shkresës me nr.1578/7 prot., datë 28.05.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Albdesign PSP" sh.p.k.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin "*Ketu permendim qe nga ana e AK mund te kerkohen te paraqiten dy makineri te ndryshme secila me nga nje funksion pra nje per mbledhjen e letres dhe nje per birosjen e saj, e rendesishme per autoritetin eshte te realizohet kontrata por jo me kriteret diskriminuese duke vendosur kushte perjashtuese vetem per nje makineri, per me teper kur procesi i kesaj makinerie (ai i mbledhjes) nuk eshte i lidhur ngushte me faktin nese letra eshte apo jo e birosur, pasi makinerite e mbledhjes se letres e mbledhin letren ne cdo lloj versioni dhe formati. Sa me siper kerkojme qe kriteri per makineri te percaktohet sakte dhe qarte duke u ndare dhe duke u percaktuar qe makineria per mbledhjen e letres eshte e ndryshme nga ajo e birosjes pra per te plotesuar kerkesat e autoritetit kontraktor te percaktohet qe te paraqiten dy makineri te ndare vec e vec te cilat kryejne funksionet e kerkuara nga autoriteti. Pra nje makineri per mbledhjen e letres dhe nje makineri per birosjen e letres dhe nuk ka pse te kerkohet vetem nje makineri qe kryen te dyja funksionet, duke lene hapesire per nje pjesemarrje me te gjere dhe duke mos penguar dhe perjashtuar operateve ekonomike te interesuar, pasi ne kete gjykim te autoritetit kontraktor i bie te kerkonte nje makineri per te gjitha funksionet, kriter ky diskriminues. Autoriteti kontraktor duhet te percaktojte kriteret minimale dhe te tilla qe te lejoje nje pjesemarrje te gjere"* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në dokumentat e tenderit, shtojca 9, pika 2.2.3 dhe 2.2.4, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

“2.2.3. Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- makineri parapergatitje CTP;*
- makineri shtypi ne rrulon;*
- makineri celefonimi;*
- si dhe makineri per mbledhjen e letres me birosje.*

Disponimi i makinerive te mesiperme te vertetohet duke paraqitur fature blerje ose dokument zhdoganimi ose ne rastin e marrjes me qera duhet paraqitur kontrate qeraje te noterizuar.

2.2.4. Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- makineri dixhitale per printimin e te dhenave variabel;*
- si dhe makineri per numrator dhe barkod dixhital.*

Disponimi i makinerive te mesiperme te vertetohet duke paraqitur fature blerje ose dokument zhdoganimi ose ne rastin e marrjes me qera duhet paraqitur kontrate qeraje te noterizuar.”

III.1.2.Me anë të shtojcës ”Njoftim modifikimi” të ngarkuar në SPE, nga autoriteti kontraktor janë bërë ndryshimet lidhur me kriteret e vecanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

”[...]Kriteri 2.2.4. ishte: Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabel;*
- si dhe makineri për numrator dhe barkod dixhital.*

Disponimi i makinerive të mësipërme të vërtetohet duke paraqitur faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qera duhet paraqitur kontratë qeraje të noterizuar.

Kriteri 2.2.4 bëhet: Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- makineri dixhitale për printimin e të dhënave variabel;*

Disponimi i makinerisë së mësipërme të vërtetohet duke paraqitur faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qera duhet paraqitur kontratë qeraje të noterizuar.

Kriteri 2.2.5. ishte: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatë ISO 27001: 2013; (ose ekuivalente)*
- Certifikatë ISO 14298 : 2013 (certifikatë sigurie shtypi); (ose ekuivalente)*
- Certifikatë ISO 14001: 2004 (ose ekuivalente)*
- Si dhe Certifikatë OHSAS 18001: 2007 (ose ekuivalente)*

Certifikatat e mësipërme të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri 2.2.5. bëhet: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatë ISO 14001: 2004 (ose ekuivalente)*
- Si dhe Certifikatë OHSAS 18001: 2007 (ose ekuivalente)*

Certifikatat e mësipërme të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.[...]”

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”*

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në rastin konkret është kërkuar një makineri për mbledhjen e letres me birosje, të cilën autoriteti kontraktor e gjykon të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor është e nevojshme që nëpërmjet kriterëve të vecanta të kualifikimit të sigurohet që operatorët ekonomik pjesëmarrës disponojnë kapacitetet teknike (makineritë) për kryerjen me sukses të furnizimit objekt i prokurimit. Në rastin konkret, kërkesa e 1 makinerie që kryen edhe funksionin e mbledhjes edhe funksionin e birosjes është kufizuese, pasi operatorët ekonomikë mund ti plotësojnë këto kapacitete me më shumë se 1 makineri. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: 2. *Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës me argumentin se “Verejme se ne dokumentat e tenderit janë kerkuar mostrat të cilat kanë një kosto për operatorin ekonomik dhe në kushtet kur autoriteti kontraktor ka kerkuar një sere deshmish për të vertetuar se operatori ekonomik plotëson kërkesat minimale, mendojme se nuk është e domosdoshme të kerkohen edhe mostra për çdo produkt. Qëllimi i autoritetit kontraktor arrihet me se miri edhe nëse autoriteti kontraktor kerkon mostra nga një të tille për çdo grup artikuj duke mos krijuar edhe kosto për operatorin ekonomik si edhe duke mos krijuar konfuzion edhe në depozitimin e tyre pranë autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9, pika 2.2.7, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar: “2.2.7. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi mostra/modele për zerat 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 32, 33, 34, 35, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 dhe 55 të përcaktuara në sasitë dhe grafikun e levrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Operatori Ekonomik, për artikujt me Barkode EN-AA, EB-AA, RR-AA, RR-AL, CP-AA dhe CP-AL, duhet të paraqesë të pakten nga 100 cope etiketa për secilin. Barkodi për këto etiketa duhet të realizohet sipas algoritmit të dhënë në specifikimet teknike, pasi në momentin e testimit nga Posta Shqiptare algoritmi duhet të rezultojë i vlefshëm dhe të lexohet nga sistemi. Gjithashtu për artikullin Etiketa CN e kuqe dhe Etiketa jeshile E10 OE duhet të paraqesë nga 100 cope për secilin”

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]”

III.2.3. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.4. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Synimi i autoritetit kontraktor është shprehur në disa drejtime si në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi në të cilën ka parashikuar mbi cilësinë dhe specifikimet teknike të produktit final. KPP konstaton se për përmbushjen e synimit të këtij autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit kriterë kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik (makineri, staf etj) si edhe kriterë kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, por kërkesa për dorëzimin e 100 copë mostra për secilin artikull me barkode EN-AA, EB-AA, RR-AA, RR-AL, CP-AA dhe CP-AL, Etiketa CN e kuqe dhe Etiketa jeshile E10, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon se, është e mjaftueshme që operatorët ekonomik pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mostër) për secilin produkt që do të prokurohet, me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të sipërcituar sipas konstatimeve të mësipërme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Blerje Shtypshkrimesh*”, me nr. REF-66306-04-30-2018, me fond limit 44,607,547 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albdesign PSP” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 931 Protokolli, Datë 18.05.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha